URDHËR
Nr. 78, datë 9.4.2014

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 15.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të pikës V/2, germa "a", të vendimit nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Autorizimet për dërgimin me shërbim të punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit jashtë qendrës së punës, brenda vendit, në largësi mbi 100 km, të lëshohen nga drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.
2. Në ushtrimin e kësaj kompetence, drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit të zbatojë kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", të ndryshuar.
3. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ZHVILLIMIT
URBAN DHE TURIZMIT
Eglantina Gjermeni